



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PUSTEC
KËSHILLI BASHKIAK

Pustec, më 24.04.2026

PROCESVERBAL

Lloji i mbledhjes: e rregullt

Vendi i mbledhjes: salla e mbledhjeve të Këshillit

Ora e fillimit: 12⁰⁰

Kryeson mbledhjen: kryetari i këshillit z.Naum Damo

Të pranishëm nga administrata janë: sp.PAK, znj.Para Trajko, sp.finance znj.Donka Sotiri, sp.jurist znj.Klodjana Sotiri, sp.projekteve dhe ndihmës së huaj znj.Elona Ballauri, sp.agronom zhj.Grozda Argjir.

Këshilltarë të pranishëm në sallë janë: Naum Damo, Moza Simon, Spase Tërpo, Vasilika Kolefski, Vaska Vasilovski, Adelina Tërpo, Taqo Grozdani, Bllagica Mihal, Jani Apostol, Nada Gjoli.

I pranishëm në mbledhje Kryetari i Bashkisë z.Pali Kolefski

Kryetari i këshillit: përshëndetje të gjithëve, fillojmë me kourumin e mbledhjes, këshilltarë të pranishëm në momentin e hapjes së mbledhjes janë **tetë**, kuorumi miratohet. Faleminderit!

Shënim: këshilltarja Nada Gjoli erdhi në mbledhje pas përfundimit të pikës 5 nga rendi i ditës, kurse këshilltari Jani Apostol erdhi në mbledhje pas shqyrtimit të pikës 7 të rendit të ditës.

Në mbështje të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, neni 52 “konflikt interesi” të gjithë këshilltarët që jemi të pranishëm duhet ta plotësojmë deklaratën e konfliktit të interesit.

Shënim: asnjë këshilltar nuk është në konflikt interesi me ndonjë nga pikat e rendit të ditës.

Faleminderit!

Vazhdojmë me shtjellimin e pikave të rendit të ditës

1. Për miratimin e rendit të ditës së mbledhjes

Kryetari i këshillit: Ka ndonjë pyetje? E kalojmë në votim? Pro? Kundër? Abstenim? Miratohet me 8 vota pro, 0 vota kundër, 0 vota abstenim. Faleminderit !

2. Për miratimin e procesverbalit të mbledhjes së kaluar

Kryetari i këshillit: Ka ndonjë pyetje? E kalojmë në votim? Pro? Kundër? Abstenim? Miratohet me 8 vota pro, 0 vota kundër, 0 vota abstenim. Faleminderit !

3. Për miratimin e bllok ndihmës ekonomike nga fondi 6% për muajin mars 2026

Sp.NE-përsëritje, në bazë të verifikimeve të bëra nga grupi i kontrollit i ngritur nga ana e Bashkisë për verifikimin e familjeve të cilët kanë dalë jo përfituese nga skema e ndihmës ekonomike ,të cilat do të trajtohen nga fondi i kushtezuar për bllok-ndihmen ekonomike deri në 6% rezultojnë për këtë muaj të kemi një ndryshim, pasi është hequr z.Gjergji Simon pasi ka dalë në pension.

Këshilltarja Moza Simon-nëse personat dalin në pension nuk mund të pranohen tek 6%?

Sp.PAK- po po bie automatikisht nga skema. Është një nga pikat që mund të përfitoj nga skema 6% pasi është pensionist.

Kryetari i këshillit: Ka ndonjë pyetje? E kalojmë në votim? Pro? Kundër? Abstenim? Miratohet me 8 vota pro, 0 vota kundër, 0 vota abstenim. Faleminderit !

4. Për një gabim material në VKB nr. 23 datë 24.03.2026 “Për miratimin e strukturën nivelin e pagave të administratës dhe agjencisë të Bashkisë Pustec për vitin 2026”.

Sp.jurist-do të bëhet ndryshimi i pagës së gjendjes civile, ku në bazë të VKM duhet të bëhet ndryshim në pagë ku nga 98 000 do të shkojë 102 000.

Prefektura ka bërë një rekomandim në bazë të VKM që ka ardhur nga Prefektura duhet të bëhet ky ndryshim. Celja e pozicionit që ne e kemi është një pozicion që është në nivelin përgjegjës dhe niveli për përgjegjësin është ky.

Këshilltari Taqo Grozdani- po të keni fonde bëni rritje.

Sp.jurist- Fondi për pozicionit e përgjegjës të gjendjes civile vjen nga Ministria .

Kryetari i këshillit: Ka ndonjë pyetje? E kalojmë në votim? Pro? Kundër? Abstenim? Miratohet me 8 vota pro, 0 vota kundër, 0 vota abstenim. Faleminderit !

5. Për miratimin e kalimit të aksioneve të Bashkisë Pustec nga shoqëria “KRËM” SH.A, tek shoqëria “AKEM” SH.A.

Kryetari i bashkisë- ne jemi pjesë e shoqërisë së menaxhimit të mbetjeve për Qarkun e Korçës dhe selinë e ka në Maliq. Aty ne paguajmë kuotën që cojmë mbetjet ku në bazë të peshimeve deri tani

për këtë vit që është mbyllur ka qenë 18 euro për ton vec transportin që bëjmë ne peshohen dhe paguhën. Tani do të bëhet një ndryshim nuk do të jetë në rang rajonal por do të jetë në rang kombëtar, do të jetë një stad më sipër ku të gjithë shoqëritë e menaxhimit të mbetjeve urbane do të varen nga një ndërmarrje/shoqëri që do të jetë në Tiranë, prapë do të jetë me aksione ku në këtë rast do të jetë Korca për të gjithë bashkitë e qarkut tonë. Ne jemi ndër të parët që po i kalojmë aksionet pasi sot pasi kemi mbledhjen më herët. Kjo nuk do të ndikoj tek Bashkinë tonë as financiarisht asgjë pasi vetëm 1 % të aksioneve kishim na

Këshilltari Taqo Grozdani- kjo 1% sa është vlera e asaj?

Kryetari – tani kemi bikancin e firmës, deri tani nuk është shlyer investimi, kjo është financuar nga KFË kur është bërë, Bashkia nuk kishte cuar asnjehere mbetje kurse për ne është viti i tretë që cojmë mbetje. Ne momentalisht jemi në bisedime për një ndërtim të një vendgrumullimi mbetjesh në Goricën e Madhe.

Kryetari i këshillit: Ka ndonjë pyetje? E kalojmë në votim? Pro? Kundër? Abstenim? Miratohet me 9 vota pro, 0 vota kundër, 0 vota abstenim. Faleminderit !

6. Për shtyrjen e afatit të kontratës së qirasë për pasurinë nr. 285/21 (ish-godina e bashkisë), në funksion të shoqërisë SHRUK Korçë SH.A

Kryetari i Bashkisë- Gjatë periudhës së zbatimit të kësaj kontrate, Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Korçë Sh.A. ka përbushur të gjitha detyrimet kontraktore, të parashikuar në kontratë që ishte njëvjeçare, kurse me këtë projekt akt që kemi sot do të kemi një drryshim pqë zgjatjen e kontratës për një periudhë 5 vjeçare.

Kryetari i këshillit: Ka ndonjë pyetje? E kalojmë në votim? Pro? Kundër? Abstenim? Miratohet me 9 vota pro, 0 vota kundër. Faleminderit !

7. Për konstatimin e përfundimit të mandatit të dy anëtarëve të Këshillit të Bashkisë Pustec

Kryetaria e komisionit të mandateve znj.Moza Simon- Komisioni i Mandateve, pasi shqyrtoi dokumentacionin përkatës dhe evidencat e pjesëmarrjes në mbledhjet e Këshillit Bashkiak Pustec, konstatoi se dy këshilltarë, Z. Stavre Stavre dhe Z. Miallaq Nikolla, nuk kanë marrë pjesë në mbledhje për një periudhë mbi 6 muaj dhe nuk kanë paraqitur asnjë justifikim zyrtar, pavarësisht njoftimeve të rregullta nga administrata. Në këto kushte, Komisioni vlerëson se kjo mungesë përbën shkelje të detyrimeve ligjore dhe shkak për përfundimin e mandatit të tyre. Komisioni i Mandateve propozon para Këshillit Bashkiak konstatimin e përfundimit të mandateve për këshilltarët në fjalë dhe vijimin e procedurave për zëvendësimin e tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Kryetari i këshillit: Ka ndonjë pyetje? E kalojmë në votim? Pro? Kundër? Abstenim? Miratohet me 9 vota pro, 0 vota kundër, 0 vota abstenim. Faleminderit !

8. Miratimin e abonimit të Bashkisë Pustec në gazetën “Ilinden” dhe përcaktimin e burimit të financimit.

Kryetari i bashkisë- Shoqata Maqedonase “Ilinden” ka paraqitur kërkesë për abonimin e Bashkisë Pustec në gazetën “Ilinden”, një botim në gjuhën maqedonase me rëndësi kulturore dhe informuese për komunitetin maqedonas në Shqipëri. Abonimi parashikon furnizimin me 25 kopje mujore, me kosto vjetore 20,000 lekë. Duke vlerësuar rëndësinë e kësaj nisme për ruajtjen e identitetit kulturor dhe gjuhësor, propozohet miratimi i abonimit dhe financimi i tij nga buxheti i Bashkisë Pustec për vitin 2026

Kryetari i këshillit: Ka ndonjë pyetje? I kalojmë në votim? Pro? Kundër? Abstenim? Miratohen me 9 vota pro, 0 vota kundër, 0 vota abstenim. Faleminderit !

9.Për miratimin e Planit të Veprimit të Administrimit të tokës bujqësore

Sp.agronom-Plani i Veprimit për Mbrojtjen dhe Administrimin e Tokës Bujqësore 2026–2030 i Bashkisë Pustec është një document që synon përdorimin e qëndrueshëm, mbrojtjen dhe përmirësimin e tokës bujqësore për zhvillimin afatgjatë të bujqësisë lokale. Dokumenti analizon gjendjen aktuale të bujqësisë në Bashkinë Pustec, ku sektori mbetet aktiviteti kryesor ekonomik, por përballët me sfida serioze si fragmentarizimi i tokës, mungesa e sistemeve funksionale të ujitjes dhe kullimit, mekanizimi i kufizuar, emigrimi i popullsisë dhe degradimi i tokës. Plani përcakton objektiva kryesore si mbrojtja e tokës nga degradimi dhe ndërtimet informale, rikuperimi i infrastrukturës ujitëse e kulluese, rritja e produktivitetit, ndërtimi i pikave të grumbullimit të peshkut, bimëv emedicinale, përmirësimi i administrimit të tokës dhe mbështetja e fermerëve përmes praktikave moderne. Gjithashtu, ai synon orientimin e zhvillimit drejt bujqësisë organike, turizmit rural dhe investimeve publike e private për të garantuar zhvillim ekonomik të qëndrueshëm dhe ruajtje të burimeve natyrore në territorin e Bashkisë Pustec.

Këshilltari Spase Tërpo u shpreh se, përpara zbatimit të pikave të parashikuara në Planin e Bujqësisë, është e domosdoshme që fillimisht të trajtohen disa problematika bazë që ndikojnë drejtpërdrejt në menaxhimin e tokës bujqësore në zonë. Një nga shqetësimet kryesore aktuale është prania e gardheve që rrethojnë sipërfaqe të ndryshme toke të mbjella me çaj mali apo kultura të tjera bujqësore, të cilat janë vendosur nga fermerët si masë mbrojtëse për shkak të mungesës së kontrollit dhe menaxhimit të kafshëve, veçanërisht gomarëve dhe lopëve. Sipas tij, kjo situatë tregon se zona ende përballët me problematika elementare të administrimit dhe kontrollit të territorit bujqësor, ndaj duhet që në fillim të ndërmerren hapa konkretë për menaxhimin e lire të levizjes së kafshëve dhe heqjen graduale të këtyre pengesave, duke krijuar kushte më të rregullta për përdorimin e tokës. Vetëm pas adresimit të këtyre çështjeve praktike dhe themelore, mund të kalohet me efikasitet në zbatimin e plotë të objektivave dhe masave strategjike që parashikon Plani i Bujqësisë.

Këshilltari Taqo Grozdani- theksoi se Bashkia Pustec, pavarësisht përmasës së vogël territoriale, ka avantazhin e bashkëpunimit më të lehtë ndërmjet komunitetit dhe aktorëve lokalë. Sipas tij, kjo përbën një mundësi konkrete për krijimin e ndërmarrjeve apo shoqërive të vogla të përbashkëta në sektorë me potencial si peshkimi, bujqësia dhe kultivimi i bimëve medicinale. Ai nënvizoi se organizimi në struktura të tilla do të rriste mundësitë për zhvillim ekonomik lokal dhe përfitim nga programet mbështetëse, duke përfshirë aplikimet në fondet IPA, të cilat mund të shërbejnë si burim financimi për realizimin e këtyre projekteve.

Kryetari i Bashkisë - sqaroi se miratimi i Planit të Bujqësisë është një avantazh i rëndësishëm për Bashkinë, pasi përmes përcaktimit të qartë të prioritetëve dhe pikave kryesore të zhvillimit, krijohet baza e nevojshme institucionale për aplikime në programe dhe fonde të ndryshme mbështetëse. Ai theksoi se, nëse objektivat dhe nevojat konkrete nuk janë të parashikuara në një plan zyrtar, bëhet shumë më e vështirë ose e pamundur përfshirja në skema financimi apo projekte zhvillimore. Prandaj, ekzistenca e Planit të Bujqësisë i jep Bashkisë mundësinë të aplikojë në mënyrë të strukturuar për projekte në fusha si bujqësia, peshkimi, bimët medicinale dhe sektorë të tjerë prioritarë, duke e kthyer planin në një instrument praktik për sigurimin e investimeve dhe zhvillimit lokal.

Kryetari i këshillit- Kryetari i Këshillit u shpreh se është dakord me qëndrimin e këshilltarit Spase Tërpo, duke theksuar se përpara zbatimit të plotë të pikave të parashikuara në Planin e Bujqësisë, fillimisht duhet të adresohen problematikat më të menjëhershme në terren, siç është çështja e gardheve që pengojnë menaxhimin dhe përdorimin më të rregullt të tokës bujqësore. Sipas tij, zgjidhja e këtyre problemeve bazë përbën një hap të domosdoshëm praktik, mbi të cilin më pas mund të mbështetet zbatimi më efektiv i objektivave dhe masave të planit.

Kryetari i këshillit: Ka ndonjë pyetje? I kalojmë në votim? Pro? Kundër? Abstenim? Miratohen me 10 vota pro, 0 vota kundër, 0 vota abstenim. Faleminderit !

10.Për nxjerjen jashtë përdorimit të automjetit tip Sharan të Bashkisë Pustec.

Specialisti/Juristi sqaroi se për automjetin është ndjekur e gjithë procedura ligjore përkatëse, duke përfshirë hartimin e dokumentacionit të nevojshëm, procesverbalet e komisionëve dhe administrimin e akteve përkatëse, ndaj çështja paraqitet në mbledhjen e Këshillit për miratim sipas procedurës.

Në vijim, këshilltari Taqo Grozdani pyeti mbi gjendjen aktuale të automjetit që propozohet të nxirret jashtë përdorimit.

Në përgjigje, Specialisti/Juristi bëri me dije se automjeti është plotësisht jashtë funksionit, nuk ofron më asnjë shërbim për institucionin dhe, për shkak të gjendjes së tij, mund të trajtohet vetëm për shitje si skrap.

Kryetari i këshillit: Ka ndonjë pyetje? I kalojmë në votim? Pro? Kundër? Abstenim? Miratohen me 10 vota pro, 0 vota kundër, 0 vota abstenim. Faleminderit !

DISKUTIME

Njohja e këshilltarëve me sondazhin e plotësuar online për PBA 2027-2029

Në kuadër të hartimit të Programit Buxhetor Afatmesëm 2027–2029 (Faza I), u zhvillua një proces konsultimi publik për identifikimin e nevojave dhe prioriteteve të komunitetit. Për shkak të mungesës së pjesëmarrjes në takimet fizike, u realizua një pyetësor online për përfshirjen e qytetarëve. Nga rezultatet, problemet kryesore të evidentuara janë infrastruktura rrugore, kanalizimet dhe papunësia. Si prioritete për investime u theksuan infrastruktura, zhvillimi i turizmit dhe agroturizmit, si dhe mbështetja për bujqësinë dhe punësimin. Qytetarët u shprehën përgjithësisht të informuar dhe vlerësuan shërbimet si të mira, ndërsa kërkuan më shumë komunikim përmes rrjeteve sociale dhe takimeve publike. Këto gjetje do të shërbejnë si bazë për orientimin e politikave dhe investimeve në kuadër të buxhetit afatmesëm.

Njohja e këshilltarëve me Raportin e monitorimit të buxhetit për vitin 2025 të Bashkisë Pustec

Gjatë vitit 2025, Bashkia Pustec ka realizuar të ardhura më të larta se plani, duke arritur 142% të tij, kryesisht për shkak të të ardhurave të paplanifikuara dhe TAP. Megjithatë, të ardhurat nga taksat vendore nuk janë realizuar plotësisht, duke treguar nevojë për përmirësim në mbledhjen e tyre. Shpenzimet buxhetore janë realizuar në masën 67% të planit, ku mosrealizimi lidhet kryesisht me vonesa në prokurime, shtyrje të investimeve dhe realizim të pjesshëm të projekteve. Investimet kapitale mbeten të ulëta dhe në shumë raste në faza fillestare. Në nivel strukture financiare, bashkia vazhdon të ketë varësi nga transfertat qeveritare, të ardhura të veta të kufizuara dhe peshë të lartë të shpenzimeve për personelin. Edhe pse vihet re përmirësim në krahasim me vitin 2024, sidomos në rritjen e të ardhurave dhe disiplinën financiare, sfidat kryesore mbeten në planifikimin dhe zbatimin e investimeve. Në përfundim, viti 2025 karakterizohet nga rritje e të ardhurave, por jo plotësisht e qëndrueshme, si dhe nga nevoja për përmirësim të menaxhimit të shpenzimeve dhe përsheptim të investimeve. Prioritet mbetet forcimi i mbledhjes së të ardhurave, përmirësimi i planifikimit buxhetor dhe rritja e eficiencës në zbatimin e projekteve.

11. Miratimi i bashkëfinancimit të projektit “Shërbime sociale dhe kujdesi për persona me aftësi të kufizuara në Bashkinë Pustec” për vitin 2026 Afati: Mars 2026 – Dhjetor 2026

Specialisti i Projekteve theksoi se kjo është hera e parë që Bashkia Pustec përfiton fonde nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për zbatimin e planit social në mbështetje të personave me aftësi të kufizuara.

Ai sqaroi se viti i kaluar ishte viti i parë i zbatimit të këtij projekti, i cili është parashikuar si një program 3-vjeçar me skemë bashkëfinancimi, ku mbështetja financiare e Ministrisë vjen në ulje progresive nga viti në vit.

Konkretisht:

- Në vitin e parë, Ministria mbuloi 90% të financimit të projektit;
- Në vitin e dytë, Ministria financon 60%, ndërsa Bashkia mbulon 40% përmes kostove të stafit dhe buxhetit të saj;
- Në vitin e tretë, financimi nga Ministria zbret në 30%, duke kaluar një peshë më të madhe financiare tek Bashkia.

Sipas saj, kjo formë financimi synon jo vetëm mbështetjen fillestare të projektit, por edhe krijimin e kapaciteteve të qëndrueshme në nivel vendor për vijimin e shërbimeve sociale ndaj personave me aftësi të kufizuara.

Këshilltari Spase Tërpo pyeti mbi numrin e personave përfitues që kanë marrë shërbim në kuadër të projektit.

Në përgjigje, Specialisti i Projekteve sqaroi se aktualisht janë 30 persona përfitues të përfshirë në këtë shërbim. Ai theksoi gjithashtu se, sipas objektivave të projektit, parashikohet realizimi i 700 vizitave në vit, ndërsa gjatë vitit të kaluar janë tejkuluar këto pritshmëri, duke u realizuar rreth 1000 vizita psiko-sociale. Kjo, sipas tij, dëshmon një angazhim të lartë në ofrimin e shërbimeve dhe një mbulim më të gjerë të nevojave të përfituesve.

Kryetari i këshillit: Ka ndonjë pyetje? I kalojmë në votim? Pro? Kundër? Abstenim? Miratohen me 10 vota pro, 0 vota kundër, 0 vota abstenim. Faleminderit !

Faleminderit të gjithëve për prezencën tuaj. Këtu mbyllet mbledhja për muajin shkurt. Faleminderit!

MIRATUAN
Sekretar i këshillit

Todora TËRPO

